



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Nëmbela: Unit: Jednitsa:	KO
Nr. Prot.: Prot. No.: Br. Prot.:	28/2019
Nr. I faqeve: No. of pages: Br. stranica:	-03-
Data: Date: Datum:	17.12.2019
Pristina/ë	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF 28/2019

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 23, paragrafit 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 17 dhjetor 2019, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUOTËS SË ANËTARËSISË

**Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët të cilët ushtrojnë veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës**

- I. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e punësuar në institucione publike dhe private, për mjekët e pensionuar që ushtrojnë veprimtarinë mjekësore si të punësuar, specialistët dhe mjekët nga Lugina e Preshevës, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);
- II. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e papunë nga kategoritë e cekura në paragrafin I (mjekët shtetas kosovarë, mjekë të pensionuar që nuk ushtrojnë veprimtarinë mjekësore, specialistë pa kontratë pune dhe mjekët e papunë na Lugina e Preshevës) në shumë prej 40.00 (Katërdhjetë) € (euro);
- III. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e rinjë shtetas kosovar dhe mjekët e rinjë nga Lugina e Preshevës, të cilët kryejnë provimin e licencës për herë të parë gjatë vitit kalendarik përkatës pas datës 1 korrik dhe anëtarësohen në OMK, në shumë prej 20.00 (njëzetë) € (euro);

- IV. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi kosovare të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë vendit dhe dëshirojnë vullnetarisht të regjistrohen dhe të anëtarësohen në Odë, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);
- V. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi të huaj në shumë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjet) € (euro);

### **Mënyra e ekzekutimit të pagesës së kuotës së anëtarësimit vjetor**

- I. Mjeku i cili punon në institucionet shëndetësore publike do t'i bëhet ndalesa automatike e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore me pagën e muajit shkurt të vitit kalendarik përmes sistemit të pagave-Payroll, ose përmes sistemit të pagesave të OMK-së jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik.
- II. Mjeku i cili punon në institucionet shëndetësore private, mjeku i pensionuar që ushtron veprimtarinë mjekësore si i punësuar, specializanti dhe mjeku i punësuar nga Lugina e Preshevës obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .
- III. Mjeku shtetas kosovarë, mjeku i pensionuar që nuk ushtron veprimtarinë mjekësore, specializanti pa kontratë pune dhe mjekët e papunë nga Lugina e Preshevës obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .
- IV. Mjeku qytetar jo Kosovarë i cili ushtron veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës, obligohet që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .
- V. Mjeku me shtetësi kosovare i cili ushtron veprimtarinë mjekësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës e që vullnetarisht anëtarësohen në OMK, obligohet që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .



## **Pasojat juridike për shkelje të obligimit të anëtarësimit**

Të gjithë mjekët që nuk i kryejnë obligimet sipas këtij Vendimi, lidhur me pagesën e kuotës së anëtarësisë, Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim i OMK-së, përmes Vendimit të formës së prerë do të ndërpres anëtarësimin në OMK sipas Nenit 15 paragrafi me nenparagrafin 1.4. të Statutit të OMK-së.

## **Hyrja në fuqi**

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative në OMK.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së.

Vendimi është i zbatueshëm nga data 1 Janar 2020.

Prishtinë, 17.12.2019

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. sci

